

PROJEKTLIGJ

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9917, DATË 19.5.2008, “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pika 2 e nenit 2 ndryshohet si vijon:

“2. “Bankë guaskë’ është një institucion kreditor apo financiar , apo një institucion që kryen aktivitetet të ngjashme me ato që kryhen nga institucionet bankare dhe financiare, e themeluar në një juridiksion të caktuar por që nuk ka prani fizike, përfshirë drejtim dhe administrimi, si dhe nuk është pjesë në një grup të rregulluar financiar.”.

- Në pikën 10, në fund të paragrafit të parë, prapa togfjalëshit “Në këtë kategori përfshihen” shtohet shprehja “ambasadorët dhe të ngarkuarit me punë, si edhe”.
- Pas pikës 10 të nenit 2 shtohen pikat 10/1 dhe 10/2 me përmbajtjen si vijon:

“10/1. Anëtarët e familjes të personit të ekspozuar politikisht janë:

- (a) bashkëshorti/ja, apo bashkëjetuesi/sja e një personi të ekspozuar politikisht;
- (b) fëmijët dhe bashkëshortët/et e tyre, apo bashkëjetuesit/set , të një personi të ekspozuar politikisht;
- (c) prindërit e një personi të ekspozuar politikisht.

10/2 Personat që njihen si bashkëpunëtorë të ngushtë të personave të ekspozuar politikisht në interpretim të këtij ligji janë:

- (i) individët që kanë pronësi përfituese të përbashkët në persona juridikë apo organizime ligjore, apo çfarëdo marrëdhënie tjetër të ngushtë biznesi, me një person të ekspozuar politikisht;
- (ii) personat të cilët janë pronarët përfitues të vetëm të një personi juridik apo organizimi ligjor i cili dihet se është krijuar për përfitim de facto të personit të ekspozuar politikisht;

iii çdo person tjetër sipas përcaktimeve të dhëna në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

- Pika 19 ndryshohet dhe bëhet:

“19. “Trust” është marrëdhënia ligjore midis të gjallëve apo për shkak të vdekjes, me të cilën një person, themeluesi, vendos asetë nën kontrollin e një kujdestari për llogari të një përfituesi apo për një qëllim të posaçëm. Trusti ka karakteristikat e mëposhtme:

- a) Asetet formojnë një zë të ndarë dhe nuk përfshihen në pasurinë e kujdestarit;*
- b) Titulli i aseteve të trustit mbahet nga kujdestari apo nga një person tjetër për llogari të kujdestarit.*
- c) Kujdestari ka të drejtën dhe detyrën për të kryer me përgjegjshmëri menaxhimin, përdorimin, disponimin e aseteve në përputhje me kushtet e trustit dhe detyrimet e posaçme të parashikuara me ligj.”.*

- Në pikën 26, pas numrit (vi) shtohet numri (vii) me përmbajtje:

“vii) ofron shërbimin e “kujdestarit të portofolit”, sipas rregullimit të legjislacionit të fushës për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë;”.

- Pas pikës 28 shtohet pika 28/1 me përmbajtje:

“28/1. Person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit është zyrtari apo punonjësi me njohuri të mjaftueshme për rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të institucionit dhe të ketë kompetencë për të marrë vendime dhe që nuk nevojitet, në të gjitha rastet, të jetë anëtar i bordit të drejtorëve.”.

- Në pikën 29 hiqet fjala “financiar”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Tek gërma (e) pas togfjalëshit “agjent, broker, shtëpi brokerimi “ shtohet togfjalëshi “komisioner dhe të ngjashëm”;
- Tek gërma (gj), në paragrafin e parë togfjalëshi “audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar” shfuqizohet;
- Tek gërma (gj), në paragrafin e parë , pas togfjalëshit “ ... dhe profesionet e tjera të rregulluara kur përgatisin transaksione...” shtohet togfjalëshi “apo kur ata marrin pjesë duke vepruar në emër dhe për llogari të klientit të tyre në çfarëdo transaksion financiar apo të pasurive të paluajtshme, apo duke ndihmuar në planifikimin dhe kryerjen e transaksioneve për klientët e tyre, apo kryejnë veprime të tjera që mund të

rezultojnë si mbështetje për përcaktimin e vlerës së kuotave të pronësisë apo për kryerjen e transaksioneve të mëposhtme”;

- Tek gërma (gj) në pikën (i) togfjalëshi “*të letrave me vlerë*” zëvendësohet me fjalën “*titujve*”;
- Tek gërma (gj), pika (ii) riformulohet si vijon “*ii hapjen apo administrimin e llogarive bankare, të kursimeve apo të kasetave të sigurisë*”;
- Tek gërma (gj) në pikën (iv) pas fjalëve “*krijimin, funksionimin...*” shtohen fjalët “*...blerjen, shitjen*”;
- Tek gërma (gj), pika (v) pas togfjalëshit “*dhe transferimin e veprimtarive tregtare,*” shtohet togfjalëshi “*rritjet apo pakësimet e kapitalit, përcaktimin e pjesëve*”;
- Tek gërma (gj) shtohet pika (vi) me përmbajtje

“vi) aktet që lidhen me njohjen dhe shlyerjen e detyrimeve ndërmjet personave.”.

- Në gërmën (h) pas togfjalëshit “*që lidhen me blerje ose shitje të pasurive të paluajtshme*” shtohet togfjalëshi “*apo kur veprojnë si ndërmjetës në dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, në lidhje me transaksionet për të cilat qiraja mujore arrin në vlerën e barabartë apo më të madhe se 500 000 Lek, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura.*”;
- në gërmën (k) tek numri (v) në fillim të fjalisë hiqen fjalët “*.. shitblerjen e veprave të artit apo*”.
- në gërmën (k) pas numrit (v) shtohet numri (v/1), (v/2) me përmbajtje si vijon:

“(v/1) shitblerjen apo ndërmjetësimin e veprave të artit, përfshirë kur kjo kryhet nga galeritë e artit apo shtëpitë e ankandeve, kur vlera e transaksionit të vetëm apo e transaksioneve të lidhura me njëra tjetrën është në vlerë të barabartë apo më të madhe se 1 000 000 (një milion) Lek, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura.”.

(v/2) magazinimin, shitblerjen apo ndërmjetësimin e veprave të artit, kur kjo kryhet në “zonat e lira”, kur vlera e transaksionit të vetëm apo e transaksioneve të lidhura me njëra tjetrën është në vlerë të barabartë apo më të madhe se 1 000 000 (një milion) Lek, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura”

- Pas gërmës (ll) shtohen gërmat (m), (n), (nj), (o) me përmbajtje si vijon:

m) çdo individ, person fizik apo juridik, të cilët tregtojnë mallra apo shërbime në masën që kryejnë apo pranojnë pagesa në para fizike në një shumë prej 1 000 000 (një milion) lek ose më shumë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura.

n) “audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar dhe këshilltarët tatimorë,

- nj) çdo person tjetër që merr përsipër që të ofrojë, drejtpërdrejt apo nëpërmjet personave të tjerë me të cilët ai person ka lidhje, ndihmë materiale, asistencë apo këshillim për çështje tatimore, si biznes kryesor apo veprimtari profesionale;*
- o) shoqëri komisionere, sipas përcaktimit të legjislacionit të fushës për tregjet e kapitalit.”.*

Neni 3

Në nenin 3/1 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

- Në pikën 2 fjala “*organizimet*” zëvendësohet me fjalët “*Kujdestarët e organizimeve*”;
- Shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“4. Personi përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të organizimeve ligjore që rrjedhin nga ky ligj është kujdestari i këtyre organizimeve.”.

Neni 4

Në nenin 4/1 “Masat e vigjilencës së duhur” bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

- tek pika 1, gërma (b) shtohet numri (iii) me këtë përmbajtje:

“(iii) të verifikojnë identitetin e përfituesit të personit juridik apo të përfituesit, të mire besuarit të organizimit ligjor në kohën e pagesës ose në kohën e ushtrimit të të drejtave të fituara nga përfituesi;”.

- tek pika 1, pas gërmës (b) shtohet gërma (b/1) me këtë përmbajtje:

“b/1). Për personat juridik që merren me sigurimin e jetës apo sigurimet e tjera të lidhura me investimet përveç ushtrimit të detyrueshëm të masave që duhet të ndërmerren për ushtrimin e vigjilencës së duhur ndaj klientit dhe pronarit përfitues, institucionet financiare apo kredituese marrin masat e mëposhtme ndaj përfituesit të sigurimit të jetës dhe policave të tjera të sigurimit të lidhura me investimet, sapo përfituesi/sit identifikohen apo përcaktohen:

i) në rast të përfituesve të identifikuar si person të emëruar specifikisht apo në rastin e organizimeve ligjore, merret emri i personit;

ii) në rastin e përfituesve të përcaktuar në bazë të karakteristikave, klasës apo nga mjete të tjera, institucionet financiare apo kredituese duhet të marrin informacion të mjaftueshëm në lidhje me përfituesin/ sit, për të përcaktuar identitetin e përfituesit në kohën e pagesës.

Në lidhje me pikat (i) dhe (ii), verifikimi i identitetit të përfituesve do të bëhet në momentin e kryerjes së pagesës. Në rastin e kryerjes, tërësisht ose pjesërisht, të sigurimit të jetës ose të investimet në dobi të një pale të tretë, institucionet financiare apo kredituese duhet të identifikojnë pronarin përfitues në kohën e caktimit të personit fizik, të personit juridik apo të organizimit ligjor që përfiton nga polica e sigurimit.”.

Neni 5

Në nenin 5, pas pikës 2 shtohet pika 2.1 me përmbajtje:

“2.1 Për klientët rastësorë që kryejnë transaksione në vlera më të vogla se 100,000 lek, ruajtja e kopjes së dokumenteve identifikuese nuk është e detyrueshme. Për këta klientë regjistrohen së paku të dhënat e emrit, mbiemrit, datëlindjes, numrit personal për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë të barasvlershëm për shtetasit e huaj dhe autoritetin që e ka lëshuar.”.

Neni 6

Në nenin 6/1 “Mbështetja në palë të treta” në fund fjalisë të pikës 4 shtohet togfjalëshi “, apo kur pala e tretë mund të konsiderohet si pjesë e subjektit.”.

Neni 7

Në nenin 8 bëhen këto shtesa:

- Pas pikës (5) shtohen pikat (5/1) dhe (5/2), me përmbajtje si vijon:

5/1. Vigjilenca e zgjeruar kryhet edhe në raste të tjera të konsideruara me risk të lartë sipas vlerësimit të vetë subjektit. Në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që lidhen me llojin e klientëve, zonës gjeografike, produkteve, shërbimeve, transaksioneve apo kanaleve të veçanta të shpërndarjes, subjektet e këtij ligji marrin parasysh faktorët dhe situatat e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

5/2. Në lidhje me marrëdhëniet e biznesit apo transaksionet që përfshijnë vendet me risk të lartë sipas nenit 22 gërma “f” të këtij ligji, subjektet duhet të zbatojnë masat e mëposhtme të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit:

- i) të marrin informacion shtesë për klientin dhe pronarin (et) përfitues ;*
- ii) të marrin informacion shtesë mbi natyrën e marrëdhënies së biznesit ;*
- iii) të marrin informacion mbi burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë së klientit dhe pronarit (ëve) përfitues ;*
- iv) të marrin informacion mbi arsyet e transaksioneve të synuara ose të kryera;*
- v) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë vendimmarrës për vendosjen ose vazhdimin e marrëdhënieve të biznesit ;*
- vi) të kryejnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënieve të biznesit duke rritur numrin dhe “shpeshtinë ose periodicitetin” e kontroleve të aplikuara, dhe zgjedhjen e modeleve të transaksioneve që kanë nevojë për ekzaminim të mëtejshëm.*

Krahas masave të mësipërme, në zbatim të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, subjektet zbatojnë një ose më shumë nga këto masa shtesë lidhur me klientët apo transaksionet që përfshijnë vende me risk të lartë:

- i) të zbatojnë elementë shtesë të vigjilencës së zgjeruar ;*
- ii) të përdorin mekanizma të përmirësuar për raportime apo raportim sistematik të transaksioneve financiare ;*

iii) të kufizojnë marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet me individët apo persona juridikë nga vendet me risk të lartë.”.

Neni 8

Në nenin 10 pas pikës (5) shtohet pika (6) me përmbajtje:

“6. Detyrimet e këtij neni zbatohen nga ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale.”.

Neni 10

Në nenin 11 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në pikën 1, gërma (a/1) prapa numrit (ii) shtohet fjalia:

“Faktorët minimalë që duhet të vlerësohen janë:

- 1- Qëllimi i hapjes së llogarisë apo vendosjes së marrëdhënies;*
 - 2- Niveli i asetëve që do depozitohen nga klienti apo madhësia e transaksioneve;*
- Rregullshmëria ose kohëzgjatja e marrëdhënies së biznesit.”.*

- Në pikën 1, gërma (a/1) numri (iii) ndryshohet dhe bëhet:

“iii) të marrin në konsideratë vlerësimet kombëtare të riskut, vlerësimet sektoriale, të dhëna të tjera të ngjashme, rekomandimet e autoritetit përgjegjës dhe/ose autoriteteve mbikëqyrëse, si dhe vlerësime ose raporte, të hartuara nga organizata ndërkombëtare dhe autoritete me kompetencë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmi, përsa i përket riskut që përbëjnë vende të treta të veçanta.”.

- Në pikën 1, pas pikës b, shtohet pika b/1 me këtë përmbajtje:

“b/1. Personi përgjegjës i emëruar sipas parashikimeve të pikës 1.b të këtij neni është personi që dërgon raportet sipas nenit 12 pika 1 dhe 2 të këtij ligji, si dhe kthen përgjigje kërkesave të autoritetit përgjegjës;”.

- Në pikën 1, në gërmën (d) pas togfjalëshit *“dhe financimit të terrorizmit”* shtohet togfjalëshi me përmbajtjen *“përfshirë detyrimin për mosdeklarim sipas nenit 15 të këtij ligji, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale,”.*

- Shtohet pika (5) me përmbajtje:

“5. Kur një individ që bën pjesë në kategoritë e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji ushtron veprimtarinë profesionale si i punësuar i një personi juridik apo personi fizik tregtar, detyrimet e këtij neni zbatohen vetëm nga punëdhënësi.”.

Neni 11

Neni 19 shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- tek gërma (ç) pas fjalës “inspektimet” shtohet togfjalëshi “ në vend dhe në distancë”;
- pas gërmës (d) shtohet gërma (d/1) me përmbajtje:

“d/1. mund të refuzojë shkëmbimin e informacionit me agjencitë homologe të huaja vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur shkëmbimi vlerësohet se është në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit shqiptar”.

- Pas gërmës (e) shtohet gërma (e/1) me përmbajtje:

“e/1 mund të refuzojë kërkesat për informacion nga organet e zbatimit të ligjit kur:

i) dhënia e informacionit cenon një hetim apo analizë të nisur;

ii) dhënia e informacionit është qartazi jo në proporcion me interesat e ligjshme të një personi apo pa lidhje me qëllimin për të cilin është bërë kërkesa.”.

Neni 13

Në nenin 22/1 “Organizimi i autoritetit përgjegjës” pas paragrafit të dytë, shtohet paragrafi i tretë me përmbajtje:

“ Organet përkatëse duhet të informojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për përdorimin e informacionit apo të dhënave të dërguara kryesisht nga kjo e fundit, si dhe për rezultatet e hetimeve apo të inspektimeve të bazuar mbi të dhënat dhe informacionin e dërguar.”.

Neni 14

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me përmbajtje:

“Neni 24/1

Masa shtesë për vendet me rrezik të lartë

Autoritete mbikëqyrës dhe/ose licencuese, si dhe subjektet e këtij ligji zbatojnë edhe masat e mëposhtme në raport me vendet rrezik të larte:

i) refuzimin e themelimit të filialeve apo degëve apo zyrave përfaqësuese të subjekteve nga vende me risk të lartë, apo në raste të tjera të merret në konsideratë fakti se subjekti është nga një shtet i cili nuk ka apo nuk zbaton sisteme të duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

ii) ndalimi i subjekteve që të themelojnë degë apo zyra përfaqësuese në vendin me risk të lartë, apo të merret parasysh fakti se dega apo zyra përfaqësuese përkatëse do të ishte në një

vend i cili nuk ka apo nuk zbaton sisteme të duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

iii) të kërkohet mbikëqyrje e shtuar apo kërkesë e shtuara për auditim të jashtëm për degët dhe filialet e subjekteve të që gjenden në vendin me risk të lartë;

iv) të kërkohet shtimi i kërkesave për auditim të jashtëm për grupet financiare në raport me cilëndo prej degëve dhe filialeve të tyre që gjenden në vendin me risk të lartë;

v) të kërkohet nga institucionet kreditore dhe financiare që të rishikojnë dhe ndryshojnë, apo nëse është e nevojshme që të përfundojnë, marrëdhëniet korresponduese me institucionet përkatëse në vendin me risk të lartë.”

Neni 15

Në nenin 28 bëhen shtesat dhe ndryshimet:

- Në pikën 1 togfjalëshi “, Agjencinë Shtetërore e Kadastrës” shfuqizohet.
- Pika 2 ndryshohet dhe bëhet:

“2. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive i paraqet periodikisht dhe sa herë ndryshohet, autoritetit përgjegjës listën e plotë dhe të përditësuar të personave të ekspozuar politikisht, duke përfshirë detajet e nevojshme për identifikimit e personave, funksionin, datën e emërimit/largimit, personat e lidhur, për 3 vitet e fundit, të hartuar sipas parashikimeve të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.”.

- Në pikën 3, gërma (a) ndryshohet dhe bëhet:

“a) mënyrat dhe procedurat për zbatimin nga subjektet raportuese, të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;”.

- Në pikën (3), gërma (ç) shfuqizohet.

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.